

VENDIM
Nr.314, datë 24.5.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.704, DATË 16.11.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRFAQËSIMIT, TË
PËRZGJEDHJES, EMËRIMIT E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE DHE RREGULLAT
E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 10 të vendimit nr.704, datë 16.11.2005 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Statistikave shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhje, përkatësisht, në masën 20 për qind dhe 10 për qind të pagës së Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it. Kur këshilli mblidhet më shumë se një herë në muaj, anëtarët përfitojnë shpërblim vetëm për një mbledhje.

Efektet financiare të përballohen nga fondet buxhetore, miratuar për INSTAT-in.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2006.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha